



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.07.2014, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”
- 3 . Projektligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj dhe Blendi Klosi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Silva Caka, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Gjovalin Bzheta dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Elisa Spiropali – drejtore e Përgjithshme e Doganave

Blerta Kraja – zëvendës drejtore e Doganave

Ervina Domi – drejtore juridike e Doganave

Genci Celi – përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Adelina Greca - drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

Jonida Gaba - zëvendësdyrektore e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit
Iglon Peçi - drejtor i Drejtorisë Juridike në MZHUT

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmbërëma!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për dy çështje, të cilat janë vazhdim i mbledhjeve të mëparshme.

Para se të fillojmë mbledhjen e komisionit, besoj se biem të gjithë dakord për të vetmen gjë, që jemi me konsensus 100%, t'i urojmë zotit Braho: Edhe 100!

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Janë dispozitat e mbetur pezull nga mbledhja e mëparshme lidhur me Kodin Doganor.

Ju lutem të jeni të vëmendshëm!

Pastaj kemi projektligjin “Për planifikimin e territorit”.

Neni 13. Kemi rënë dakord për një ndryshim te neni 13. Ka një propozim edhe nga ekspertët tanë. (I drejtohet këshilltares).

Erida, keni rënë dakord për këtë me Drejtorinë e Doganave, lidhur me “statusin, kategorizimin e të drejtave dhe të detyrimeve të personelit të administratës doganore”?

Jeni dakord? Dogana është dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka. Dakord.

Neni 15 “Marrëdhëniet e punës pranimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm pezullimi dhe largimi nga detyra i personelit të administratës doganore”, siç është parashtruar këtu.

Dogana?

Elisa Spiropali – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Kolegët? Dakord.

Neni 15, aq janë 10 nene, që ikemi lënë nga rradha e kaluar.

Kemi propozimet e kreut 3. “Të drejtat dhe detyrimet e personave sipas legjislacionit doganor”.

Kemi nenet 60, 61 që janë propozimet e zotit Vasili. Janë konsultuar, u konsultuan edhe me Komisionin e Ekonomisë. Komisioni i Ekonomisë do t'i marrë në shqyrtim. Jeni dakord që t'ia kalojmë Komisionit të Ekonomisë për shqyrtim?

Kush është dakord? Kundër? Dakord.

Neni 64 “Aktet zbatuese”. Kemi bërë një ndryshim në këtë dispozitë aktet nënligjore. Kemi rënë dakord për procedimin e rregullave procedurale.

Dakord? Dakord.

Neni 84 “Dispozita të përgjithshme” me ndryshimin që kemi bërë.

Kush është dakord? Kundër ? Nuk ka. Miratohet.

Neni 181 me rregullimin që i është bërë. Kush është dakord? Kundër ? Nuk ka. Dakord. Miratohet.

Kemi propozimin e neneve 227, 228 dhe 229, të prezantuar nga kolegja Caka në mbledhjen e kaluar. Edhe këto do t'i kalojmë për shqyrtim si propozime në Komisionin e Ekonomisë.

Kush është dakord me 227? Dakord.

Kush është dakord me 228, ku shtohen pikat 3,4? Dakord.

Neni 229, shtohen pika 4 dhe 5. Kush është dakord? Dakord.

Neni 250, pika 3, ndryshimi është riparë.

Kush është dakord? Dakord.

Elisa Spiropali – Pika 2.

Fatmir Xhafaj- Më falni pika 2?

Elisa Spiropali – Po, po edhe pika 3.

Fatmir Xhafaj - Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 253 sugjerohet të .. “kundërvajtjet e kryera me dashje”

Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 258 “Sanksionet për kundërvajtjet e kryera me dashje në bashkëpunim dhe tentativë”. Ndryshim termi.

Dakord? Janë dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 260 “Kundërvajtjet e kryera në të njëjtën kohë”.

Dakord? Janë dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 262 “Caktimi i llojit dhe masës së sanksioneve dhe kundërvajtjet administrative.” Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 263 “Parashkrimi” Titullohet “Parashkrimi”, jo “Kufizimi” siç është. Ndryshohet. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 266 numërohet 267 dhe shtohet neni 267 “Për raste të veçanta të kontrabandës” Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 268. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 269. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 270 Procedimi penal. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 271 me ndryshimin e bërë. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 272 pika 1 sugjerohet të ndryshohet.

Elisa Spiropali - Te 272 cili është sugjerimi? Se me duket se nuk ka dakordësi për këtë nen.

Fatmir Xhafaj - Pika 1.

Neni 273 “Procedurat e verifikimit” Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 277 Kalimi i dosjes tek organet e procedimit penal. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Neni 282 “Ankimim ndaj vendimit të autoritetit të doganave në lidhje me një borxh dhe ose me sanksione”. Dakord? Dakord kolegët. Kundër? Nuk ka.

Në nenin 292 shtohet pika 8 “Dispozitat tranzitore” Dakord? I kalojnë të gjitha Komisionit të Ekonomisë. Në tërësi kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Ka një abstenim. Zoti Peza dakord? Dakord me një abstenim.

Miratohet.

I kalojnë Komisionit të Ekonomisë si komision përgjegjës.

Faleminderit, zonja Drejtoreshë! Faleminderit edhe stafit tuaj! Punë të mbarë dhe suksese!



PROCESVERBAL

Datë 17.07.2014, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj dhe Blendi Klosi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Silva Caka, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Gjovalin Bzheta dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Adelina Greca - drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

Jonida Gaba - zëvendës drejtore e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

Iglon Peçi - drejtor i Drejtorisë Juridike në MZHUT

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”...

Dakord!

Armando Subashi – Po mund ta themi ndryshe.

Fatmir Xhafaj – Neni 6. Dakord? Neni 7. Dakord? Neni 8. Keni rënë dakord për një riformulim.

(Diskutime pa mikrofon)

Pse? Jam te neni 8 tani.

(Diskutime pa mikrofon)

Po unë isha te neni 5. Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, e votova atë.

Jam te neni 8: “Këshilli kombëtar i territorit”.

Me ndryshimin e bërë, Këshilli Kombëtar i Territorit është organ qendror vendimmarrës, përgjegjës në nivel kombëtar për miratimin e instrumenteve të planifikimit dhe kontrollit...” Sipas përcaktimit të këtij ligji, KKT-ja është organ ndërministror, që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe drejtohet nga Kryeministri.

Dakord me ndryshimin?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam vërejtje për nenin 8. Pika 3 e nenit 8 thotë: “Mbledhjet e KKT-së janë të hapura, përveçse kur përcaktohen ndryshe me ligj”. Nuk e kuptoj këtë. Ose janë të hapura, ose kur thuhet “përveç se kur përcaktohen ndryshe me ligj”, ky është ligji që po bëjmë ne.

Tani, me ligj ne themi: do të bëhen të hapura.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Gaba.

Jonida Gaba – Mund të ketë ligje të posaçme për interesa kombëtare, shtetërore, që për arsye të ndryshme mund të jenë jo publike; mund të jenë të sigurisë kombëtare dhe kanë nevojë të jenë të mbyllura. Në qoftë se s’ka ndonjë ligj të posaçëm, janë të hapura në përgjithësi.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Fino.

Këtë besoj se do ta mbajmë parasysh: funksionimin e organeve kolegjiale, parimin e përgjithshëm. Këtë kanë pasur parasysh. Ka një rregullim të posaçëm dhe ky është rregulli i përgjithshëm për funksionimin e organeve kolegjiale, por gjithsesi, dakord.

Po, zoti Fino. Si mund ta themi ndryshe?

Bashkim Fino – Jo, unë nuk jam kundër që ndonjëherë KKT-ja mund të bëjë edhe pa medien. Nuk jam kundër kësaj. Unë jam kundër mënyrës se si është shkruar, sepse thuhet: “Mbledhjet e KKT-së janë të hapura, përveçse kur përcaktohen ndryshe me ligj”.

Me cilin ligj? Ky është ligji.

Fatmir Xhafaj – Por mund të ketë në dispozitat e mëposhtme. Ka raste?

(Diskutime pa mikrofon)

Jonida Gaba – Shikojmë ligjet e tjera, është fjala.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po, po.

Bashkim Fino – S’kam asnjë vërejtje se si është koncepti. Për konceptin s’kam vërejtje. Unë kam vërejtje ku thuhet se mbledhjet e KKT-së janë të hapura, përveçse kur vetë anëtarët e KKT-së, me kryeministrin në krye, mund të mendojnë se një çështje e caktuar mund të mos jetë e hapur. Mund ta caktojnë vetë ata, me rregullore të brendshme, por jo me ligj tjetër. Hajde gjeje me ligj tjetër tani. Si do t’u thuash medieve ti, kur ke një mbledhje: shiko, në ligjin e planifikimit të territorit ne e kemi të hapur mbledhjen, por shiko se, kemi bërë një ligj tjetër për, ku di unë, për ndërtimin e veprave ushtarake, ndaj për këtë pikë ju mediet do të dilni përjashta.

Më mirë me rregulloren e brendshme, që ka KKT-ja. A ka rregullore të brendshme të funksionimit? Ata ta caktojnë vetë. Ta caktojnë vetë me rregulloren e tyre.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord të ketë një rregullim këtu, me propozimin e zotit Fino? Dakord me ndryshimin e nenit 1, që u miratua dhe nenit 3, me ndryshim. Dakord?

Dakord. Neni 8 dakord.

Neni 9, me sugjerimin e bërë.

Zonja Greca.

Adelina Greca – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Fjalët “merr vendim” zëvendësohen me fjalën “vendos”. Dakord? Dakord me nenin 9.

Neni 10. “Ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit të territorit”.

Dakord?

Neni 11.

(Diskutime pa mikrofon)

Për nenin 11?

Po, se edhe unë këtu...

(Ndërprerje incizimi)

Bashkim Fino – Kam dy pyetje. Kam edhe dy propozime. Pyetja ime e parë është: Ç’e ka shtyrë ministrinë të krijojë një agjenci të planifikimit të territorit, kur ka një ministri me këtë emër, kur mund të krijonte një drejtori të përgjithshme? Se në fund të fundit, kjo agjenci prapë në varësi të ministrit është ose jashtë ministrisë.

Pyetja e dytë, zoti kryetar, që të mos e marr fjalën prapë, në qoftë se ju jeni dakord: në pikën 3 të nenit 11, thuhet se struktura dhe organika e AKPT-së përcaktohet me urdhër të Kryeministrit. Dakord. S’kam asnjë vërejtje. Le ta lëmë Kryeministrit të miratojë edhe strukturën, por kush ia propozon? S’ia propozon askush? Pra, a duhet shënuar këtu s eia propozon ministri i linjës, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Ashtu siç thotë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ta mbaroj. Unë pikërisht këtë them: që duhet edhe propozimi. Kush e bën propozimin?

(Diskutime pa mikrofon)

Po s’është shënuar këtu. Apo...

(Diskutime pa mikrofon)

Sepse te pika 4 e po këtij neni thuhet: “Veprimtaria e AKKT-së drejtohet nga titullari i tij, i cili emërohet, lirohet, shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Fatmir Xhafaj – Me propozimin e ministrit përgjegjës.

Bashkim Fino – Me propozimin e ministrit përgjegjës. Pra, për ta emëruar drejtorin apo për ta shkarkuar, propozon ministri, por strukturën e bën vetë Kryeministri. Kjo nuk ka sens të rrijë.

(Diskutime pa mikrofon)

S’kam mbaruar, s’kam mbaruar.

(Diskutime pa mikrofon)

Edhe këtë, e nuk flas më. Do të iki, se do të drejtoj komisionin tim.

(Diskutime pa mikrofon)

Meqenëse ju shquheni për memorie të fortë për diskutimin tim, ja ku e kemi në një ligj shumë të rëndësishëm; edhe kur folëm atëherë për strukturën e policisë, që thamë se

realisht duhet ta miratojë Kryeministri, me propozim të ministrit dhe nuk mund ta miratojë strukturën ministri, si dhe të emërojë e të çëmërojë njëkohësisht.

Këto kisha për këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërprerje incizimi)

(Diskutime pa mikrofon)

Iglon Peçi – Me sa kuptova, pyetja ishte për AKPT-në si organ i ri, në fakt, ka qenë AKPT-ja si organ i ri. Nuk mund të futet pjesë e strukturës së ministrisë, sepse ka detyra funksionale. Ministria është në kuadrin e hartimit të politikave, kurse AKPT-ja është edhe në kuadrin e inspektimit e hartimit të instrumenteve dhe monitorimit të planifikimit. Lidhur me pjesën e organizimit të funksionimit, ose qoftë edhe emërimit të titullarit të agjencisë, është në përputhje me ligjin “Për funksionimin e organeve shtetërore”.

Pra, struktura dhe organika për të gjitha institucionet e varësisë bëhet me urdhër të Kryeministrit, kurse emërimi i titullarit bëhet me urdhër të titullarit të organit të varësisë.

Lidhur me propozimin, dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 11 miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Me sa kuptova nga përgjigjja e përfaqësuesit të qeverisë, dua të bëj pyetjen e dytë tani. Agjencia Kombëtare e Planifikimit do të bëjë politika, apo s’do të bëjë politika? Dua ta di vërtet këtë gjë, se nuk e kuptoj. Po nuk bëri politika, t’i bëjë vetëm ministria, në rregull, por, a do të bëjë politika, apo s’do të bëjë? Këtu thotë: “Agjenci Kombëtare e Planifikimit të Territorit është institucioni qendror buxhetor publik, në varësi të ministrit...” e të tjera.

Do të bëjë politikë, apo s’do të bëjë?

Fatmir Xhafaj – S’kemi vajtur te përgjegjësia e agjencisë. Jemi te detyrat.

(Diskutime pa mikrofon)

Mos është për nenin pasardhës.

Po, zonja Greca.

Adelina Greca – A mund ta identifikoni ç’doni të thoni me bërrje politikash në këtë fushë?

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Jo, ju lutem.

Bashkim Fino – Ja, po e përkthej ndryshe. Unë bëra një pyetje se pse duhet të krijohet agjencia, kur ne mund të kemi një drejtori të përgjithshme. Përgjigjja që m’u kthye

ishte se ministria bën politika, agjencia është një instrument që do të bëjë kontrollin e territoreve e të tjera me radhë. Domethënë, më latë të kuptoja se Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit nuk do të bëjë politika. Unë prandaj e bëra pyetjen: nuk do të bëjë politika? Nëse nuk do të bëjë politika, do shikuar ligji në tërësi pastaj, sepse këtu gjithë vitin tregojnë se bëjnë politika. Tani, si ta bëj ndryshe unë pyetjen, se s'e kuptoj. Mund të jap edhe një variant tjetër?

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, mund të jap një sugjerim. Një sugjerim që ta marrin për detyrë shtëpie e të më kthejnë përgjigje nesër.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Bashkim Fino – Ose mbas një jave.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ta kthejmë detyrën në seancë. Në seancë të kthejë përgjigje.

Bashkim Fino – Po e dua këtu. Ç'domethënë kjo, në seancë?

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 11 miratohet me ndryshimin e pikës 3, sipas vërejtjes së zotit Fino. Dakord.

Neni 12: “Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”.

Ka vërejtje? Sugjerime? Dakord.

Miratohet.

Neni 13. Dakord.

Neni 14. Dakord.

Neni 15. Më falni, te neni 14 ka disa vërejtje që janë bërë nga këshilltarët. Keni rënë dakord, apo jo? Në pikën 2, 3, dakord? Hiqen fjalët “në strukturën përgjegjëse” e të tjera e të tjera. Dakord?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Neni 14 ka të bëjë me autoritetet e planifikimit vendor. Këtu duhet të kemi një çikë kujdes, sepse nuk mund ta urdhërojmë autoritetin e pushtetit vendor për të ngritur struktura, për të pasur struktura e të tjera e të tjera. Absolutisht që ata do të kenë struktura, se është në të drejtën e tyre të ngrenë struktura për planifikimin e territorit, por t'i thuash autoritetit të qeverisë vendore të sigurojnë strukturën përgjegjëse, e të tjera, duhet terminologji jo urdhëruese.

Fatmir Xhafaj – “Cakton”, thuhet këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Ah, në rregull, e kanë hequr. Është ai ndryshimi që thashë unë, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam edhe një gjë tjetër, zoti kryetar. Ky nen, mbas gjysmë ore që, besoj do të kalojë reforma territoriale, kam përshtypjen se do të bjerë.

Fatmir Xhafaj – Mua më duk sikur shkon me reformën territoriale.

Bashkim Fino – Do të bjerë, sepse nuk përputhet aspak me reformën territoriale.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Bashkim Fino – Sepse... ja, më dëgjoni, mbani qetësi.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Bashkim Fino – Në nenin 14, pika 3, po të lexoni germat “a”, “b”, “c” dhe “d”, nuk ka më mbi dhjetë mijë, njëqind mijë e të tjera me radhë.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Bashkim Fino – Sepse ne kemi vendosur një kriter kur kemi bërë ndarjen territoriale dhe presupozojmë që kjo maxhorancë dhe kjo qeveri të miratojë reformën territoriale, jo më shumë se gjashtëdhjetë apo shtatëdhjetë njësi vendore, që minimalisht do të kenë mbi 35 mijë banorë. Ndaj duhet të përputhen këto, sespe, meqenëse kemi fatin e madh që të dyja projektligjet do të kalojnë në këto dy javë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk flas më. Do të them këtë që kam merak. Kam edhe shumë vërejtje të tjera, por nuk flas më. Tani unë po them: ligjet nuk duhet të bien ndesh me njëri-tjetrin.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord.

Bashkim Fino – Që do të thotë: unë nuk e di, por jam i bindur se mund ta miratojmë reformën territoriale. Në momentin kur e miratojmë atë reformë, do të kemi gjashtëdhjetë apo shtatëdhjetë bashki, dhe do t'i kemi minimalisht me 40 mijë banorë. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që ne nga 400 njësi vendore duam t'i ulim...

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, si ka mundësi që këtu shënohet 10 mijë, mbi 10 mijë e të tjera me radhë? Do të thotë se kjo bie automatikisht, sepse do të ketë një kryetar bashkie dhe do të ketë njësi të tjera administrative në funksion të këtij kryetari bashkie. Kaq.

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Më fal, mund të them një gjë? Mundet?

Fatmir Xhafaj – Po.

Petrit Vasili – Problemi është i tillë. Unë jam dakord me shqetësimin e zotit Fino, por ne kemi një gjë: në reformë kemi edhe një problem. Kemi njësi vendore, që, për arsye të caktuara të kriterëve, që janë atipike dhe mund të kenë popullsi më të vogla, siç janë zonat

minoritare dhe bashkia e Tiranës dhe unë them që duhet riparë neni, por përcaktimet e tij duhen diskutuar duke i parë në ato kritere që kemi, sepse kemi një kriter që është ashtu siç thotë zoti Fino, por ka edhe përthyerje brenda: ka njësi që për arsye të caktuara, siç janë minoritetet, mund të kërkojnë një gjë tjetër. Nuk është kaq e thjeshtë për ta hequr.

Fatmir Xhafaj – Kam një pyetje unë, zonja Greca: pse mos ta lëmë me VKM, se si duhet të jetë planifikimi, në varësi me organizimin e ri të territorit? Çfarë problemi ka? Çfarë i ndryshon ligjit kjo?

Adelina Greca – Ajo që tentuam të bëjmë nëpërmjet këtij neni, është që të përcaktojmë një standard minimal profesionistësh që duhet të ketë çdo njësi vendore.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Por ne i lëmë kriterin këtu dhe Këshilli i Ministrave, në varësi me atë... Jeni dakord?

Adelina Greca – Patjetër. Kemi frikën se planifikimi në çdo rast ka çaluar për shkak të mungesës së profesionistëve. Dhe ligji është më i fortë në këtë rast.

Fatmir Xhafaj – Autoriteti qendror në zbatim të ligjit do të dalë. Do ta delegojë ligji. Zonja Gaba është juriste dhe e di këtë gjë. Juriste je apo jo?

Pra, e di këtë gjë.

Zonja Greca, mos e kini merak. Biem dakord?

Dakord.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Në pikën 4, keni një pikë “Ç”, “Për administrimin e regjistrimit GIZ dhe...”. Pse përdorni fjalë anglisht? Këtë është legjislacion shqip. A mund ta riformuloni?

E dyta. Te pika 5, ju thoni: “Nëse nuk arrijnë të përmbushen kërkesat, bëhet delegimi në përputhje me legjislacionin për pushtetin vendor”. E keni fjalën për ligjin “Organizimet dhe funksionimet e qeverisjes vendore, apo ligjet e tjera? Duhet vënë titulli i plotë i ligjit, sepse qeverisja vendore ka shumë ligje e rregullime të tjera. Duhet saktësuar.

Adelina Greca – Mënyrat e delegimit përcaktohen në atë ligj, ose mund të përcaktohen nesër në ligje të tjera. Nuk donim ta lidhnim me një emërtim ligji, sepse nesër me reformën territoriale mund të dalin ligje të tjera.

(Zoti Xhafaj vazhdon me miratimin e ligjeve, por nuk dëgjohet.)

Adelina Greca – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Zoti Xhafaj vazhdon me miratimin e ligjeve, por nuk dëgjohet.)

Adelina Greca – Këtu biem përsëri në atë çështjen e termave që thamë: pra shqip apo anglisht. “Mbarështimin” e morëm nga legjislacioni i sektorit të mjedisit. Ata shprehen në atë mënyrë, megjithatë, nëse bini dakord për “menaxhimin”, që është një fjalë e huaj...

Fatmir Xhafaj – Siç e kemi lënë këtu, po them.

“Mbarështim” është “zhvillim”, që të jemi të saktë. Mund ta bëjmë “zhvillimit të zonave”?

Blendi Klosi – Zoti Xhafaj, mendoj se nuk është për “zhvillim”. Është për shtimin e zonave të mbrojtura. “Zhvillim” është për ato që janë. Këtu është për shtimin. Për shembull, në Pezë do të krijohet një sektor i ri. Po jo ai që është.

Fatmir Xhafaj – Zonja Greca, ju lutem!

Shkon termi “zhvillim”?

Adelina Greca – Ajo që kemi dashur të shprehim nëpërmjet kësaj pike është shtimi i hapësirave të gjelbra, shtimi i numrit të pemëve etj.

Fatmir Xhafaj – Pse nuk themi “shtimi”?

Mund ta themi. U zgjidh.

Neni 32?

Dakord.

Neni 33?

Dakord.

Neni 34?

Dakord.

Neni 35?

Dakord.

Neni 36?

Dakord.

Neni 37?

Dakord.

Neni 38?

Dakord.

Neni 39?

Dakord.

Neni 40, “Takimi publik”?

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kërkoj ndjesë që po kthehem te neni 36, por nuk e kuptoj këtë shprehje: “Për aq sa nuk përcaktohen ndryshe në këtë listë, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.” Kodi është mbi këtë ligj. Është më i rëndësishëm.

(Diskutim pa mikrofon.)

Askush nuk ju lejon të përcaktoni rregulla të tjera në ligjet që ka një kod. Nëse nuk është penale, i referohesh Kodit Administrativ. Kjo nuk është e drejtë.

Adelina Greca – Mund ta riformulojmë. Ideja është që ato që nuk përcaktojnë se si llogariten afatet për lejen e gjëra të tjera që rregullohen me Kodin e Procedurave Administrative, të mos përsëriten në këtë ligj. Mund ta riformulojmë.

Armando Subashi – Hiqet vetëm fjala “ndryshe” dhe është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 40?

Dakord.

Neni 41?

Dakord.

Neni 42?

Dakord.

Neni 43?

Zoti Klosi.

Blendi Klosi – Për nenin 36 do të lëmë një hapësirë në procesverbal. Edhe me “ndryshe” nuk mjafton.

Fatmir Xhafaj – E tha zonja Gaba që do ta rregullojnë. Bashkë me këshilltarin tonë.

Neni 44?

Dakord.

Neni 45?

Dakord?

Neni 46?

Dakord.

Neni 47?

Dakord.

Neni 48? Jeni dakord me vërejtjen e bërë? Pika 1, riformulim?

Dakord.

Neni 49, “Aktet nënligjore për regjistrin”?

Dakord, me ndryshimin “Rregullat për regjistrin”.

Neni 50, “Standardet e transparencës”?

(Diskutim pa mikrofon.)

Ku është?

Adelina Greca – Pra, nëse ndërmerr nismën për të miratuar, edhe mund të miratojë. Pra, nëse ka nismën, mund të miratojë vetë procedura transparence.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për nenin 48, “Botimi në regjistër”. A ka akte të miratuara, për të cilat keni detyrimin për t’i botuar në Fletoren Zyrtare?

Adelina Greca – Sipas ligjit “Planifikimi i territorit”, botimi bëhet vetëm në regjistrin e planifikimit të territorit. Nuk kemi akte që na detyrojnë të botojmë në Fletoren Zyrtare.

Vasilika Hysi – E bëra këtë pyetje, pasi ju thoni që janë të detyrueshme për botim të gjitha projektaktet dhe aktet e miratuara, me përjashtim të atyre, thoni më pas, që janë vendosur në aktet nënligjore. Akti nënligjor nuk përcakton dot përjashtim. Përjashtime duhen bërë në ligj: cilat gjëra nuk mund të botohen. Akti nënligjor është shumë poshtë. Ky është një problem juridik: kërkoj nga dy juristët ta shohin këtë pikë.

Fatmir Xhafaj – Neni 50, me vërejtjen që bëri zoti Majko, dakord.

Neni 51?

Dakord.

Neni 52?

Dakord.

Neni 53?

Dakord.

Neni 54, me riformulimin e bërë, dakord/

Dakord.

Neni 55?

Dakord.

Neni 56?

Dakord.

Neni 57?

Dakord.

Neni 58?

Dakord.

Neni 59, me ndryshimin te pika 2?

Dakord.

Neni 60, “E drejta e transferimit”?

Dakord.

Neni 61, “E drejta para blerjes”?

Dakord.

Neni 62?

Dakord.

Neni 63?

Dakord.

Neni 64?

Dakord.

Neni 65, “Mënyra e kërkimit me autoritetet e kërkuesit”, sipas vërejtjes së bërë?

Dakord.

Neni 66?

Dakord.

Neni 67?

Dakord.

Neni 68?

Dakord.

Neni 69?

Dakord.

Neni 70, me riformulimin?

Dakord.

Neni 71?

Dakord.

Neni 72?

Dakord.

Neni 73?

Dakord.

Neni 74?

Dakord.

Neni 75?

Dakord.

Neni 76?

Dakord.

Neni 77, “Transferimi i të drejtës për zhvillim”?

Dakord.

Neni 78?

Dakord.

Neni 79?

Dakord.

Neni 80?

Dakord.

Neni 81?

Dakord.

Neni 82?

Dakord.

Neni 83?

Dakord.

Neni 84?

Dakord.

Neni 85?

Dakord.

Neni 86, me ndryshimin e bërë në pikën 2?

Dakord.

Neni 87?

Dakord.

Neni 88, me ndryshimin e bërë në pikën 1 dhe 3?

Dakord.

Neni 89?

Dakord.

Neni 90?

Dakord.

Neni 91?

Dakord.

Neni 92, me riformulimin?

Dakord.

Neni 93?

Dakord.

Neni 94, “Hyrja në fuqi”?

(Diskutim pa mikrofon.)

Kur?

Adelina Greca – Ngaqë do të bëhen aktet, hyrja në fuqi është menduar me 1 tetor.

Fatmir Xhafaj – Dakord, neni 94, me këtë ndryshim.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Komision përgjegjës është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Kalojmë në miratimin në tërësi.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Komisioni përgjegjës le të vazhdojë detyrën e tij. Këshilltarët të përgatisin vërejtjet për komisionin përgjegjës.

Faleminderit!